



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.93/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), qendra në Shtime, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.09.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), qendra në Shtime, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 3.100 (tremijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), qendra në Shtime, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 26.09.2019, me të cilën pretendon se asambleistja e Komunës së Shtimes nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës Diarta Vishesella, me datën 25.09.2019 në rrjetin e saj social facebook ka publikuar një fotografi me kryetarin e Komunës së Shtimes i cili njëkohësisht është edhe kandidat për deputet nga radhët e PDK-së z. Naim Ismajli, fotografia e publikuar është bërë në zyrën e Kryetarit të Komunës së Shtimes.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur me foto profilin e asambleistes në fjalë ku shihet fotoja e publikuar e cekur me lartë, si dhe një foto tjetër e bërë më datën 28.06.2019 ku vërteton ambientin identik të zyrës së Kryetarit të Komunës së Shtimes.

Subjekti politik PDK, në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019, theksoi se ankesa e bërë ndaj tyre nuk qëndron pasi që kandidatja në fjalë është edhe asambleiste e Komunës së Shtimes dhe si e tillë në njoftimin e saj ne facebook si kandidate e PDK-së ka shfrytëzuar një foto të bërë kohë më parë në zyrën e Kryetarit të Komunës i cili vjen po nga radhët e PDK-së, kështu që ankesa është krejtësisht e paarsyeshme dhe se nuk është shkelur asnjë normë e Kodit zgjedhor lidhur me institucionet publike për fushatë zgjedhore. Më tutje subjekti ne fjalë në përgjigje thekson se e kanë evituar shkeljen dhe se të gjitha këto veprime të ndërmarra provohen me dëshmi (foto) që i kemi bashkangjitur përgjigjes.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Diarta Vishesella asambleiste e Komunës së Shtimes nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, ka publikuar një fotografi me kryetarin e Komunës së Shtimes, i cili njëkohësisht është edhe kandidat për deputet nga radhët e PDK-së z.Naim Ismajli, ne zyrën e tij në komunë, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 35.1 të LZP-së, dhe po ashtu e njejtja ka bërë promovimin e kandidatit për deputet ne zyrën e tij në komunë gjë e cila është veprim i ndaluar sipas LPZ-së.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigje kanë deklaruar se nuk e pranojnë shkeljen e supozuar por për kundër kësaj ata e kanë evituar shkeljen gjë e cila vërtetohet me një fotografi të cilën e kanë bashkangjitur përgjigjes. Rrethana këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikoj që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.93/2019 me datën 27.09.2019

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah R. Depi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par 4 të LZP-së